



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 62/2 Prot.

Tiranë, më 07.02.2023

V E N D I M

Nr. 24, Datë 07.02.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 07, datë 11.01.2023, e B. T kundër Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të racës¹, gjendjes ekonomike² dhe gjendjes civile³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “...Jam e divorcuar dhe jetoj vetëm me vajzën e cila është nën kujdestarinë time. Ajo ndjek studimet në klasën e dytë të arsimit bazë. Jam e papunë dhe trajtohem me ndihmë ekonomike. Kam dy vjet që aplikoj për të përfutur dhe asnjëherë nuk jam shpallur fitueses edhe pse jam familje në nevojë dhe i përkas komunitetit rom.

Mbështetur në VKM nr. 511, datë 27.7.2022, “Për përfitim të bursave të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, kam aplikuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin

¹ Referuar Vërtetimit Nr. 500 prot., datë 10.01.2023, të lëshuar nga Organizata “Unioni Egjiptianët e Shqipërisë”, ankuesi i përket komunitetit egjiptian n137 Shqipëri.

² Referuar Vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë, datë 10.01.2023, ankuesja trajtohet me ndihmë ekonomike në shumën 3000 lekë.

³ Referuar Certifikatës Familjare datë 09.01.2023, ankuesja rezulton e divorcuar.

përkatës dhe tani më thonë që nuk je përfituese. Arsyen nuk e di. Po u drejtohem ju si institucion që të më zgjidhet problemi pasi shoh që kudo ku kam shkuar nuk më hapen dyert dhe më diskriminojnë duke mos më dhënë qoftë dhe një mundësi për të më shpjeguar arsyen. Unë kam aplikuar në muajin Tetor 2022 dhe listat janë miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak, i cili u mbledh në datë 28 dhjetor 2022”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe gjendjes civile, si dhe përfshirjen e fëmijës së saj në listën e përfituesve të VKB-së Korçë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 07, datë 11.01.2023, të bërë nga B. T, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 62/1, datë 17.01.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shkresor⁴ nga Bashkia Korçë dhe Këshilli Bashkiak Korçë, përsa i takon pretendimeve të subjektit ankues.

⁴ KMD ka kërkuar respektivisht:

- Informacion nga ana e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankueses.
- Kopje të listës së aplikuesve pranë Bashkisë Korçë, për përfitimin e bursave sipas VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, “Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.
- Informacion përse fëmija i subjektit ankues nuk ka përfituar nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, “Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.
- Kopje të listës së aplikuesve pranë Bashkisë Korçë që kanë rezultuar fitues, lidhur me numrin e fëmijëve që kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, “Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, duke specifikuar kriterin për të cilin kanë përfituar, për secilin rast.
- Informacion nëse fëmija përfiton nga miratimi i bursave nga fondet e vetë Bashkisë ose nga fondet buxhetore të saj, të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar (pikat 4 dhe 5 të VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, “Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar).
- Sa është numri i fëmijëve që kanë përfituar bursë nga fondet e vetë Bashkisë ose nga fondet buxhetore të saj të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar, nëse ka të tillë, duke specifikuar kriterin për të cilin kanë përfituar, për secilin përfitues. Nëse nuk ka të tillë, shpjegimet përkatëse.

Në vijim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, subjekti ankues, nëpërmjet email-it të datës 02.02.2023, ka paraqitur para Komisionerit kërkesën për tërheqjen nga ankesa e saj. Ankuesja ka konfirmuar se kërkesa për përfshirjen e fëmijës së saj në listën e përfituesve të VKB-së⁵ Korçë, ishte realizuar dhe se me ndërmjetësimin e Komisionerit konsideron të përmbushur nga ana e Bashkisë Korçë/ Këshillit Bashkiak Korçë, qëllimin për të cilin kishte paraqitur ankesën pranë KMD-së.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 07 Regj., datë 11.01.2023, të shtetases B. T, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

– Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që gjykohet i arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

⁵ Vendimi nr. 11, datë 25.01.2023, i Këshillit Bashkiak Korçë.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA